*Kompanitë e sigurimit (KS)* përbëhen nga entitetet e inkorporuara, të përbashkëta dhe të tjera, funksioni kryesor i të cilave është të sigurohet sigurimi jetësor, aksidental, sëmundja, zjarri si dhe forma të tjera të sigurimit për njësitë institucionale apo grupet e njësive.

*Fondet Pensionale (FP)* janë themeluar për qëllime të sigurimit të beneficioneve për pensionim për grupet specifike të punëtorëve dhe përbëhet nga:

- Kursimet individuale të pensioneve të menaxhuara nga KPST të plotësuara me kontribute plotësuese vullnetare të paguara nga punëdhënësi dhe punëtori, apo të dytë;
- Pensionet plotësuese të punëdhënësve, të siguruara te punëtorët nga punëdhënësi i tyre;
- Pensionet individuale plotësuese, të siguruara për personat natyror nga siguruesi i licencuar pensional.

*Ndihmësit financiar*. Në Kosovë ky nën-sektor përfshin këmbimoret dhe shërbimet e transferit të parave. Pasi që kontributi i tyre në shumat e papaguara të depozitave me institucionet tjera financiare në Kosovë është i kufizuar, pozicioni i tyre në kontrast me nën-sektorët financiarë të përmendur më parë, nuk është paraqitur ndarazi në pasqyrat përfundimtare.

*Vërejtje***:** Për shkak të mungesës së regjistrit të ndërmarrjes operuese, agjentët raportues e alokojnë biznesin e pa-inkorporuar në sektorin e korporatave jo-financiare. Kjo shpien në një dallim të shtrembëruar në mes të ekonomive familjare dhe korporatave financiare në statistikë. Organizatat jo-profitabile që shërbejnë *ekonomive familjare (OJSHEF)* përfshijnë shoqëritë fetare dhe klubet shoqërore, kulturore, rekreative dhe sportive, organizatat bëmirëse, mbështetëse dhe asistuese të financuara nga transferet vullnetare në para të gatshme apo në natyrë nga njësitë tjera institucionale.

***Instrumentet Financiare*** *(SNA 1993 compatibile)*
SNA 1993 i klasifikon po ashtu instrumentet financiare në grupe të instrumenteve me karakteristika të ngjajshme. Më e rëdësishmja në kontekstin e tanishëm është përshkruar shkurtimisht.

Valuta dhe depozitat përbëhen nga Valuta që i përfshin ato kartëmonedha dhe monedha në qarkullim; Depozitat e transferueshme i përfshijnë të gjitha depozitat që janë të shkëmbyeshme me kërkesë në të parë, lirisht të transferueshme me çek; Depozitat tjera përfshijnë të gjitha kërkesat, ndryshe nga depozitat e transferueshme, mbi bankën qëndrore, institucionet tjera depozituese. Format tipike të depozitave janë depozitat e kursimeve jo të transferueshme dhe depozitat e afatizuara. Brenda kornizës së definimit të grumbullimit të të hollave një dallim tjetër sipas maturimit fillestar është bërë.

*Letrat me vlerë përveq aksioneve* përfshijnë letrat me vlerë (bills dhe bondet), certifikatat e depozitave, letrën komerciale të tregtuar në tregjet financiare. Këto lloje të aseteve financiare nuk shfaqen ende në anën e obligimve të sektorit financiar në Kosovë.

*Kreditë* përfshijnë të gjitha asetet financiare që janë krijuar kur kreditorët japin fonde direkt te borxhlinjtë dhe evidentohen nga dokumentet e panegociueshme.

*Kapitali aksionar dhe të ngjashme* përfshin kryesisht kapitalin aksionar.

*Rezervat teknike të Sigurimit* janë nën-ndarë *në kapitalin neto të eknomive familjare në rezervat e sigurimit të jetës dhe fondet pensionale*. Rezervat e sigurimit të jetës janë konsideruar mjetet e personave të siguruar apo ekonomive familjare, dhe fondet pensionale përbëhen nga rezervat e mbajtura nga fondet e themeluara nga punëdhënësit dhe/apo punëtorët për të siguruar pensione për punëtorët pas pensionimit; Parapagesat e premiuemeve dhe rezervat përkundrejt kërkesave të papaguara. Premiumet e sigurisë duhen të paguhen në fillim të periudhës të mbuluar me sigurim, dhe kjo periudhe nuk përputhet normalisht me periudhën e kontabilitetit. Prandaj pjesët e premiumeve të sigurisë së pagueshme gjatë periudhës së kontabilitetit synojnë t'i mbulojnë rreziqet në periudhën vijuese;

*Rezervat përkundrejt kërkesave të papaguara* janë rezervat që ndërmarrjet e sigurimit i mbajnë me qëllim që t'i mbulojnë shumat që ata presin t'i paguajnë lidhur me kërkesat që ende nuk janë përfunduar apo kërkesat që ende mund të jenë të dyshimta.

*Llogaritë tjera të pranueshme/të pagueshme, kryesisht* përbëhen nga llogaritë e pranueshme dhe të pagueshme, ndryshe nga ato të përshkruara më parë me vlerën e korporatave.

**Definim-i (et) dhe shënimet Metodologjike:**

Pozicionet bilaterale të institucioneve individuale janë konsoliduar dhe si rrjedhim pozicionet bilaterale në mes të nën-sektorëve në faza të ndryshme mënjanohen që çojnë në ***pozitën e konsoliduar*** të entiteteve të konsideruara. Kjo ndryshon substancialisht nga agregimi i thjeshtë. Konsolidimi është komplet sa i përket instrumenteve financiare tradicionale. Të dhënat në dispozicion nuk lejojnë konsolidimin adekuat të akrualeve dhe shumicën e llogarive të pagueshme/të praueshme për të cilat të dhënat e raportuara nga institucionet financiare individuale nuk përmbajnë kategorizimin sektoral nga nën-sektori institucional. Për konsolidim aplikohet klasifikimi si në vijim.




Analizat e sektorit dhe nën sektorëve janë prezentuar sipas kornizës së përbashkët:

**Asetet e jashtme neto (+/-)**
- Kërkesat sipas instrumentit
- Obligimet sipas instrumentit

**Kërkesat vendore**
- Kërkesat neto ndaj sektorin e qeverisë
- Kërkesat në nën-sektorët tjerë
  - Instrumenti
    - Pala tjetër (sektori institucional)

**Obligimet vendore**
- Kërkesat ndaj nën–sektorët tjerë
  - Instrumenti
    - Pala tjetër (sektori institucional)

**Kapital aksionar dhe të ngjashme**

**Zëra të tjerë (+/-)**, përfshirë përshtatjen e konsolidimit

**Pala tjetër** (counterpart) është definuar si një sektor institucional ku mbajtësi i instrumentit ka kërkesë. Në rast të depozitave të afatizuar nga korporata jo-financiare me bankën komerciale, korporata ka kërkesë mbi bankën komerciale. Në rast të letrës me vlerë, mbajtësi ka kërkesë te emetuesi i letrës me vlerë (për shembull korporata që emeton aksione), pa marrë parasysh nga kush ishte blerë. Përgjatë linjave të njejta të arsyetimit, mbajtësi i parasë ka kërkesë ndaj emetuesit, pra bankën qëndrore. Në rastin e veçantë të Kosovës, kjo nënkupton se mbajtësit e parave kanë kërkesë të jashtme dhe regjitrohet në asetet e huaja.

Kriteret e ***rezidencës*** *të parashtruara nga* SNA 1993, nuk mund të përcjellen në të gjitha detajet, pasi që klasifikimi në rezidentë /jo-rezidentë kryesisht është bazuar në informatat mbi adresat në dosjet e institucionit raportues. Vendi i specifikuar në ato dosje nuk korrespondon me vendin ku klienti ka qendrën kryesore të interesit ekonomik.

***Vlerësimi*** i instrumenteve financiare përcjell vlerën e tregut për letrat me vlerë dhe vlerën nominale për depozita dhe kredi, që nuk janë korrigjuar për provizionet e mundshme nga kreditori. Instrumentet financiare në valutat e huaja, ndryshe nga euro, janë konvertuar përkundër normës së euro këmbimit që mbizotëron në fund të periudhës raportuese.

Pasqyra e BPK-s, "Korporatave tjera depozituese" dhe 'Korporatat Depozituese' kryhen në baza mujore, kurse ato mbi "Ndërmjetësuesit tjerë financiar", "Kompanitë e sigurimit", "Fondet pensionale" dhe "Korporatat Financiare" janë në dispozicion në baza tremujore. Të dhënat e publikuara nuk janë korrigjuar për efekte eventuale sezonale.

Vërejtje: *Të dhënat mbi skemat e Kursimeve Plotësuese Pensionale për Individë të menaxhuara nga KPST ende nuk janë vënë në dispozicion nga KPST-ja. Struktura e të dhënave në Institucionet tjera Financiare është bazuar në mostër.*

**TABELA 17: NORMAT EFEKTIVE TË KAMATËS TË APLIKUARA NGA BANKAT KOMERCIALE**

**Burimi:** Raporti i Normave të Kamatës (RNK) që raportohet nga të gjitha bankat komerciale të licencuara nga BQK-ja.

**Definicionet dhe natyra e të dhënave të mbledhura:** Tiparet kryesore janë shënuar më poshtë:

| | |
|---|---|
| 1. Institucionet raportuese | Të gjitha bankat komerciale të licencuara në Kosovë |
| 2. Instrumentet financiare | Kreditë<br>Depozitat |
| 3. Denominimi i valutave | Vetëm EUR |
| 4. Shpeshtësia | Mujore |
| 5. Palët tjera | Të gjitha korporatat vendore jo-financiare;<br>Të gjitha ekonomitë familjare vendore |
| 6. Kontratat e raportuara | Biznesi i ri gjatë muajit referues/ shumat e mbetura (varësisht nga lloji i instrumentit financiar, cf. infra) |
| 7. Lloji i normave të kamatës | Norma vjetore e kamatës duke mos përfshirë asnjë ngarkesë apo komision |
| 8. Metoda e llogaritjes | Norma vjetore e kontraktuar apo norma e përllogaritur (varësisht nga tiparet e kontratës specifike, cf. infra) |
| 9. Norma dhe volumi i raportuar | - Një normë e kamatës sipas kategorisë e llogaritur si mesatare me peshë e biznesit të ri të muajit referues apo shumat e mbetura (varësisht nga lloji i instrumentit financiar) dhe;<br>- Volumi total i biznesit të ri apo shumat e mbetura (varësisht nga lloji i instrumentit financiar).<br>Kategoria është definuar nga 5 variabla dhe formon kombinimin e:<br>- llojin e instrumentit financiar;<br>- alokimin e sektorit të palës tjetër;<br>- afati i maturimit dhe;<br>- shuma e involvuar;<br>- qëllimin e financimit në rast të kredive |

Norma vjetore për t'u raportuar nga bankat komerciale është norma e kontraktuar vjetore (AAgR) apo norma e përllogaritur vjetore (AAcR).

Norma e kontraktuar vjetore (AAgR) duhet të raportohet në të gjitha rastet ku nuk ka kapitalizim apo kapitalizimi ndjek shembullin e rregullt apo kamata ngarkohet mbi kapitalin e mbetur të papaguar dhe nuk jepet kurrëfarë grejs periudhe për pagesat e kamatës apo shlyerje të borxhit kapital.

Në të gjitha rastet tjera Norma vjetore e perllogaritur (AAcR) duhet të raportohet. Kjo është norma vjetore e kamatës që barazon të hyrat e ardhshme diskontuese të parave të gatshme me vleren nominale të kredisë apo depozitit.

Norma e kamatës e komunikuar nga bankat komerciale nuk merr parasysh normën e kamatës në të gjitha transaksionet individuale gjatë periudhës referuese, përveq: për llogarite e kursimeve dhe llogaritë rrjedhëse, ku kamata është llogaritur nga banka si:

- Norma e kamatës në çdo kontratë të mbetur në fund të muajit referues, e peshuar me vleren e mbetur të kontratës në fund të periudhës referuese, apo;
- Vlera e akumuar e kamatës (kamata e grumbulluar) gjatë muajit referues e pjestuar me mesataren e vlerave ditore të mbetura.

**Statistika -IRR**: Mesatare aritmetike e thjeshtë e normave të kamatës të raportuar nga bankat e plotësuar me variancën e standardizuar si masë e shpërndarjes rreth mesatares së thjesht të llogaritur.

1. Minimum tri observime për secilin produkt;
2. Devijimi standard i kalkuluar për secilin product si mase e shpërndarjes nepërmjet normave të interest të observuar, nuk duhet ti kaloj 0,60% për depozita dhe kredi;
3. Nëse kriteri I dytë nuk është I plotesuar, ateherë pjesëmarrja për observim nga i cili është një perjashtim, nuk duhet t'i kaloj 0, 33%.

**TABELA 20: TRANSFERTAT E JASHTME**

DALËSE: Lëvizja e të hollave nga llogaria bankare apo ndonjë korporatë tjetër financiare brenda Kosovës në llogarinë bankare apo llogaritë tjera financiare jashtë Kosovës.
HYRËSE: Lëvizja e të hollave nga një bankë jo-rezidente apo llogari tjetër e korporatës financiare në bankë apo llogari të korporatës financiare në Kosovë.
AGJENSIONET E TRANSFEREVE ELEKTRONIKE: Të gjitha institucionet jo-bankare financiare që kryejnë shërbime elektronike të dërgimit të parave (Union Financiar Prishtina, Western Union PCB, Western Union RZB, Monedha, K.L.M. Enterprises, and D.M.TH. - Money Gram).

**TABELA 26: ÇMIMET (IÇK)**

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK), filloi të publikoi Indeksin e Çmimit të Konsumit (IÇK) në shtator 2002. Periudha bazë konsiderohet maji 2002, e cila prezanton periudhën kur IÇK-ja filloi të kalkulohet. Çmimet mblidhen nga ESK-ja në baza mujore duke filluar nga data 10 deri në datën 20 brenda muajit përkatës në 10 vende të Kosovës. IÇK-ja llogaritet në bazë të 2600 çmimeve. Rezultatet paraqiten sipas COICOP, i cili është një standard ndërkombëtar për klasifikimin e konsumit privat të ekonomive familjare.

$CPI^{Y,m}$= IÇK-ja për muajin aktual të vitit aktual.

$CPI^{Y-1,m}$= IÇK-ja për muajin aktual të vitit paraprak.

IÇK-ja (nga viti në vit) $= \left[\left(\frac{CPI^{Y,m}}{CPI^{Y-1,m}}\right) - 1\right] * 100$

Paraqet përqindjen e ndryshimeve vjetore të IÇK-së, duke krahasuar muajin aktual të vitit aktual me vitin e IÇK-sëtë muajit aktual të vitit paraprak.

IÇK-ja (mesatatrja vjetore) $= \frac{\sum_{i=1}^{m} CPI^{Y,i} + \sum_{m+1}^{12} CPI^{Y-1,12}}{\sum_{i=1}^{m} CPI^{Y-1,i} + \sum_{m+1}^{12} CPI^{Y-2,12}}$

Paraqet përpjesëtimin e mesatares së IÇK-së të 12 muajve të fundit duke filluar nga muaji aktual i vitit aktual deri në muajin dhe vitin paraprak në 12 muajt e fundit.

**TABELA 28-34 : SHËNIME METODOLOGJIKE MBI PËRPILIMIN E BILANCIT TË PAGESAVE TË KOSOVËS**

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është përgjegjëse për përpilimin e Statistikave mbi Bilancin e Pagesave (BP) të Kosovës. Baza ligjore për mbledhjen dhe përpilimin e statistikave për BP-në është e paraparë me Ligjin 03/L-074 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Burimet kryesore të të dhënave për statistikat e BP-së janë: Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN), Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Anketat e Ndërmarrjeve (AN), dhe raporte tjera nga Institucionet Qeveritare. Të dhënat janë të plotësuara me informatat e marra nga burimet tjera (UNMIK-u, EULEX-i dhe Donatorët) si dhe me vlerësimet e vetë Drejtorisë së Statistikës. Përpilimi i statistikave të BP-së është bërë në pajtim me Manualin e Bilancit të Pagesave të FMN-së, botimi i pestë (BPM5). Statistika e BP-së publikohen në disa publikime të BQK-së: Raporti Vjetor, Buletini Tremujor dhe Buletini Mujor Statistikor.

Bilanci i pagesave paraqet informacion kyç statistikor ekonomik që sistematikisht përmbledhë, për një periudhë specifike kohore, transaksionet ekonomike të rezidentëve të Kosovës me botën e jashtme. Transaksionet ekonomike janë transaksione të regjistruara si transaksione hyrëse (pranime) dhe transaksione të dalëse (pagesa). Pranimet nga jashtë janë të regjistruara si kredi dhe përfshijnë transaksionet ekonomike si eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet e të ardhurave, të hyrat financiare si dhe transaksionet tjera hyrëse. Në anën tjetër pagesat nga ana e qytetarëve vendës ndaj botës së jashtme (jo rezidentëve) regjistrohen si debi dhe përfshijnë transaksionet ekonomike si: importin e mallrave, importin e shërbimeve, fluksi dalës i të ardhurave, fluksi dalës financiar dhe transfertat dalëse.

Në mënyrë konceptuale, një transaksion ekonomik i ka dy anë: diçka me vlerë ekonomike jepet dhe diçka me vlerë të njëjtë merret nëpërmes të sistemit të regjistrim të dyfishtë. Kur jepet një vlerë ekonomike, (p.sh eksportet e Kosovës) regjistrohet një kredi, ndërsa kur një vlerë ekonomike merret (p.sh importet e Kosovës) regjistrohet një debi. Kur diçka me vlerë ekonomike merret pa ndonjë vlerë ekonomike si këmbim, sistemi i regjistrimit të dyfishtë kërkon një shlyerje si imput (regjistrim transferi) me vlerë ekuivalente. P.sh ushqimi i importuar si ndihma kërkon një debi të hyrë për llojin e mallit dhe një transfer kredie si shlyerje. Shembulli i mëposhtëm ilustron se si aplikohet sistemi i regjistrimit të dyfishtë. Sipas përcaktimit të sistemit të regjistrimit të dyfishtë, hyrjet në kredi duhet të jenë të barabarta me hyrjet në debi.

| Hyrjet në kredi | Hyrjet në debi |
|---|---|
| Ndryshimet në të gjitha resurset ekonomike të ofruara nga kosovarët tek jorezidentët, duke përfshirë: | Ndryshimet në të gjitha resurset ekonomike të marra nga kosovarët prej jorezidentët, duke përfshirë: |
| - Eksporti i mallrave dhe shërbimeve | - Importi i mallrave dhe shërbimeve |
| - Të ardhurat e pranuara | - Të ardhurat e paguara |
| - Transfertat të cilat shlyhen me hyrjet në debi | - Transfertat të cilat shlyhen me hyrjet në kredi |
| - Rritja në detyrimet financiare të Kosovës ndaj jorezidentëve | - Rritja në pretendimet financiare të Kosovës ndaj jorezidentëve |
| - Zvoglimi në asetet financiare të Kosovës ndaj jorezidentëve | - Zvoglimi në pretendimet financiare të Kosovës ndaj jorezidentëve. |

**KRITERI I REZIDENCËS**. Rezidentët e Kosovës janë subjekte ligjore që janë të regjistruar dhe që veprojnë në Kosovë dhe persona fizik vendbanimi i të cilëve gjendet në Kosovë dhe të cilët nuk largohen nga Kosova për periudhë më të gjatë se një vit (përveç diplomatëve, studentëve dhe pacientëve medicinal). Për shkak të specifikës, një theks i veçantë i është dhënë trajtimit të UNMIK-ut, KFOR-it, dhe stafit ndërkomëtar në Kosovë (përjashtuar stafin e UNMIK-ut/EULEX-it).

1) **Trajtimimi i UNMIK-ut/EULEX-it.** Bazuar në kriterin e rezidencës (BPM5, paragrafi 88), UNMIK/EULEX është një organizatë ndërkombëtare dhe si rezultat plotëson kushtet për tu

klasifikuar si jorezident në Kosovë. Në këtë rast, dallimi duhet bërë ndërmjet UNMIK-ut/EULEX-it si institucion dhe stafit të UNMIK-ut/EULEX-it:

a. UNMIKU/EULEXI si institucion është trajtuar si jorezident në transaksionet e BP-së;

b. Rezidenca e stafit ndërkombëtar të UNMIK-ut/EULEX-it përcaktohet në baza të kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në Kosovë:
   i. Stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it me kontratë njëvjeçare dhe më gjatë trajtohen si rezidentë të Kosovës;
   ii. Stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it me kontratë më të shkurtër se një vit trajtohen si jorezidentë të Kosovës.

Metodologjia për kalkulimin e shpenzimeve të UNMIK-ut/EULEX-it bazohet në publikimin e UNMIK-ut "Ndikimi i UNMIK-ut në Ekonominë e Kosovës" i publikuar në korrik 2006. Të dhënat mbi UNMIK-un/EULEX-in azhurnohen në bazë të informatave që sigurohen drejtpërdrejt nga UNMIK-u/EULEX-i.

Supozimet dhe vlerësimet për transaksionet e UNMIK-ut/EULEX-it si institucion dhe stafit janë si më poshtë:

a. Shpenzimet e UNMIK-ut/EULEX-it (si institucion) për mallrat dhe shërbimet e blera nga kompanitë kosovare konsiderohen si import i UNMIK-ut/EULEX-it i mallrave dhe shërbimeve lokale (eksporte të shërbimeve qeveritare).
b. Stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it që konsiderohen rezident shpenzojnë rreth 14% të pagave të tyre në Kosovë. Pjesa e mbetur prej 76% dërgohet në vendet e tyre (si dërgesa parash) dhe 10% shpenzohet për të udhëtuar jashtë (shërbime udhëtimi).
c. Stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it si jorezident (stafi ndërkombëtar afatshkurtër i UNMIK-ut/EULEX-it) shpenzojnë 14% të pagës së tyre në Kosovë për shpenzime të jetesës.

Nëpërmes një shembulli hipotetik jemi përpjekur që të paraqesim implikimin e UNMIK-ut/EULEX-it në BP të Kosovës, të bazuar në supozimet e lartpërmendura:

Duke supozuar që buxheti i UNMIK-ut/EULEX-it është 100 €, përpjestimi është si më poshtë:

| | |
|---|---|
| — Pagat e stafit rezident ndërkombëtar | 60 |
| — Pagat e stafit jorezident ndërkombëtar | 3 |
| — Pagat e stafit lokal | 17 |
| — Mallrat e importuara | 8 |
| — Mallrat lokale të importuara | 2 |
| — Shërbimet e importuara | 6 |
| — Shërbimet lokale të importuara | 4 |
| Totali i buxhetit të UNMIK-ut/EULEX-it | 100 |

Duke aplikuar shembullin e lartëcekur në sistemin e regjistrimit të dyfishtë, shënimet në BP do të jenë si më poshtë:

| | Kredi | Debi |
|---|---|---|
| Llogaria rrjedhëse | | |
| Shërbimet e udhëtimit | | |
| Shpenzimet e jetesës së stafit jorezident të UNMIK-ut/EULEX-it (14% * 3) | 0.4 | |
| Shpenzimet e stafit rezident të UNMIK-ut/EULEX-it për të udhëtuar jashtë (10% * 60) | | -6.0 |
| Pagat e stafit jorezident të UNMIK-ut/EULEX-it | | -3.0 |
| Shërbimet qeverisë | | |

| | |
|---|---|
| Shpenzimet e UNMIK-ut/EULEX-it (si institucion) për mallra dhe shërbime lokale (2+4) | 6.0 |
| Transfertat rrjedhëse | |
| Totali i pagave të stafit të UNMIK-ut/EULEX-it (60+3+17) | 80.0 |
| Dërgesat e emigrantëve (76%*60) | -45.6 |

Për shkak të trajtimit të lartpërmendur të UNMIK-ut/EULEX-it, shpenzimet e tij për importimin e mallrave dhe shërbimeve, përveç atyre që blihen në Kosovë, konsiderohen si transaksione ndërmjet jorezidentëve, prandaj nuk paraqiten në statistikat e BP-së.

2) **Trajtimi i KFOR-it.** KFOR-i është forcë ndërkombëtare që udhëhiqet nga NATO-ja dhe që është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurt në Kosovë. KFOR ka hyrë në Kosovë më 12 qershor, 1999 me një mandat të Kombeve të Bashkuara, pas miratimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244. KFOR është kontingjent ushtarak, dhe si i tillë është jorezident i Kosovës.

3) **Trajtimi i Stafit Ndërkombëtar në Kosovë (me përjashtim të stafit të UNMIK-ut/EULEX-it).** Në pajtim me SNA 93 dhe BPM5 stafi ndërkombëtar në Kosovë i angazhuar në ofrimin e ndihmës teknike apo aktiviteteve tjera në të mirë të institucioneve të Kosovës, trajtohet në bazë të kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre. Sidoqoftë, stafi ndërkombëtar i Ambasadave dhe zyrave tjera të organizatave tjera në Kosovë (diplomatët, personeli ushtarak, dhe punëtorët tjerë të organizatave të tilla si dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët banojnë në Kosovë dhe gëzojnë imunitetin dhe privilegjet diplomatike) trajtohen si jorezidentë të Kosovës.

**LLOGARIA RRJEDHËSE.** Llogaria rrjedhëse përbëhet nga blerjet dhe shitjet e mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat dhe transferatat rrjedhëse në mes të vendit dhe botës së jashtme.

1) **Mallrat.** Burimi i të dhënave mbi statistikat e tregtisë së jashtme janë Doganat e Kosovës, të procesuara nga ESK-ja. BQK-ja, në baza mujore pranon të dhëna mbi statistikat e tregtisë së jashtme nga ESK-ja, bazuar në marrveshjen e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve. BQK-ja bën përshtatjen për raportim dhe klasifikim duke aplikuar raportin c.i.f. / f.o.b. prej 7.1% (5.6% për transport dhe 1.5% për sigurim), me përjashtim të importit nga vendet fqinje të cilat vlerësohen sipas bazës f.o.b. Përshtatjet bëhen me anë të analizimit të vlerës c.i.f. kundrejt vlerës totale të importeve të mallrave për një periudhë specifike, bazuar në Dokumentin Unik Doganor (DUD);

2) **Shërbimet.** Tregtia në shërbime paraqet provizionin e shërbimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve dhe anasjelltas. Komponenti i shërbimeve të BP-së përbëhet nga: transporti, udhëtimi, shërbimet qeveritare (që nuk përfshihen diku tjetër) dhe shërbimet tjera të cilat ndahen më tej në njësi tjera (komunikim, ndërtim, sigurime, financiare, kompjuterikë dhe informatikë, tarifat për të drejtën autoriale dhe licencën, shërbime tjera biznesore, shërbime personale dhe qeveritare);

   a. *Transporti* përfshinë transportin detar, ajror, dhe transportet tjera (p.sh. hekurudhore, tokësore dhe transporti i gazit). Këtu përfshihen lëvizjet e pasagjerëve, transporti i mallrave dhe shërbimet tjera të transportit, si: marrja me qira e aeroplanit dhe ekuipazhit, bartja e ngarkesave, magazinimi, rimorkiot, pilotimi dhe navigimi, mirëmbajtja dhe pastrimi, si dhe tarifat dhe komisionet e agjentëve të shoqëruara me transportimin e pasagjerëve/mallrave. Transporti i pasagjerëve vlerësohet në bazë të mesatares së fluturimeve nëpërmes të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës të shumëzuar me çmimin mesatar të një bilete. Të dhënat për transportimin e pasagjerëve janë marrë nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Vlera e shërbimeve për transportimin e mallrave

caktohet duke u bazuar në ndryshimin në mes të vlerës së mallrave të importuara në c.i.f. dhe f.o.b. (si debi). Raporti i transportit të mallrave kundrejt shumës totale të importeve c.i.f. konsiderohet të jetë 5.6%. Marrja e komisioneve dhe tarifave të agjentit për shërbimet e ndërlidhura të transportit si dhe tarifat e aeroportit për aterim regjistrohen si kredi;

b. *Shërbimet e udhëtimit* përfshijnë shërbimet që u ofrohen jorezidentëve gjatë udhëtimeve në Kosovë (kredi), dhe që u ofrohen rezidentëve të Kosovës gjatë udhëtimeve të ngjashme jashtë vendit (debi). Përjashtim bën personeli ushtarak dhe diplomatik (p.sh. KFOR dhe Ambasadat), shpenzimet e të cilëve llogariten si shërbime qeveritare.

1. *Udhëtime biznesi. Udhëtimi biznesor* përfshinë të gjitha llojet e udhëtimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e biznesit; udhëtimet zyrtare të punëtorëve të qeverisë; udhëtimet zyrtare të punëtorëve të organizatave ndërkombëtare (p.sh asistenca teknike); dhe punëtorët e ndërmarrjeve që nuk janë rezidentë në atë ekonomi. Udhëtimet biznesore vlerësohen në bazë të të dhënave nga ndërmarrjet dhe të dhënave nga SRTN-ja.

2. *Udhëtimi personal* përfshinë të gjithë udhëtarët të cilët udhëtojnë jashtë Kosovës dhe kthehen në Kosovë që nuk përfshihen në udhëtimet biznesore. Këtu gjithashtu përfshihen shpenzimet e akomodimit të stafit afatshkurtër të UNMIK-ut/EULEX-it (rezident) në Kosovë (në anën kredi) dhe shpenzimeve për udhëtim jashtë vendit të stafit afatgjatë të UNMIK-ut/ EULEX-it (jorezident), që konsiderohen si rezident të Kosovës (në anën debi). Supozohet se, stafi afatshkurtër ndërkombëtar shpenzon rreth 14 % të pagës së tyre në Kosovë. Ky vlerësim është bërë duke u bazuar në një studim të Zyrës për Politika Ekonomike të Shtyllës së 4-të të UNMIK-ut. Burim tjetër me rëndësi i informatës për udhëtimin personal është nxjerr nga Anketa e Buxhetit të Ekonomisë Familjare, lidhur me konsumin e diasporës kosovare gjatë vizitave të tyre në Kosovë. Vlerësimi i shpenzimeve të kosovarëve lidhur me udhëtimet për pushime është bërë duke i ndërthurur informatat nga bankat qendrore në rajon (Banka e Shqipërisë dhe Banka Qendrore e Malit të Zi), si dhe të dhënat e SRTN-së.

c. *Shërbimet Qeveritare* (që nuk përfshihen diku tjetër). Janë kategori e mbetur që mbulon transaksionet e shërbimeve qeveritare (duke përfshirë ato të organizatave ndërkombëtare) të cilat nuk përfshihen në klasifikimet e mëhershme. Shërbimet Qeveritare përfshijnë gjithashtu të gjitha transaksionet e ambasadave dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve KFOR-it. Burimet e të dhënave janë të ndryshme si: SRTN-ja, Ambasadat, Komunat, etj.

d. *Shërbimet e tjera*. Në kuadër të kësaj kategorie janë të përfshira eksportet dhe importet e shërbimeve të komunikimit, shërbimet për ndërtim, shërbimet e sigurimit, shërbimet financiare, shërbimet kompjuterike dhe informative, tarifat e të drejtës së autorit dhe të licencimit, shërbimet personale, kulturore dhe argëtuese si dhe shërbime të tjera biznesore. Në kuadër të shërbimeve të tjera biznesore (debit) janë të regjistruara pagat e punonjësve ndërkombëtar të UNMIK-ut/EULEX-it sipas kontratës me afat nën një vit dhe të cilët trajtohen si jorezident. Burim i të dhënave janë anketat e ndërmarrjeve dhe SRTN-ja.

3) **Të Ardhurat.** Komponenti i të ardhurave ndërlidhet me të ardhurat e fituara nga dy faktorë të prodhimit: puna dhe kapitali. Si rrjedhojë, të ardhurat përbëhen nga kompensimi i punonjësve dhe të ardhurat nga investimet.

a. *Kompensimi i punonjësve* përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të paguara për punëtorët jorezident në vend, apo të pranuara nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst,

përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre. Kompensimi i punonjësve i paguar për kosovarët që punojnë për organizatat ndërkombëtare dhe KFOR-in, janë të regjistruara në anën e kredisë (me përjashtim të punonjësve vendor që punojnë për UNMIK-un/EULEX-in, të cilët regjistrohen në kuadër të transfertave rrjedhëse). Kompenzimi i punonjësve kalkulohet duke u bazuar në burime të ndryshme të informatave, përfshirë të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt nga UNMIK-u/EULEX-i, KFOR-i, MEF-i, Ambasadat, dhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare;

b. *Të ardhurat nga investimet*. Mbulojnë pranimet dhe pagesat e të ardhurave të shoqëruara nga mjetet e jashtme financiare dhe detyrimet. Komponenti kryesor i të ardhurave nga investimet përfaqëson të ardhurat nga investimet direkte, portofoli dhe investimet e tjera. Forma më tipike e të ardhurave nga jashtë është interesi i fituar nga depozitat apo letrat me vlerë në bankat e huaja. Në anën e debitit janë të përfshira pagesat për investitorët direkt në Kosovë si: dividendët, fitimi i ri-investuar, pagesa e kamatës për huamarrjet nga jashtë, etj. Burimet kryesore të informatave mbi të hyrat nga investimet janë raportet e bankave komerciale, kompanitë e sigurimit dhe BQK-ja;

4) **Transferet.** Janë të hyra të kompensuara për resurset reale apo mjetet financiare të ofruara pa kthim të ndonjë të mire, shërbimi, apo mjeti financiar. Transfertat janë të identifikuara ndaras si transfere rrjedhëse ose kapitale;

a. *Transfertat kapitale* përbëhen prej transfertave të cilat (1) përfshijnë pronësinë e mjeteve fikse, (2) transfertave të fondeve të lidhura me, apo të kushtëzuara ndaj, përvetësimit apo disponimit të mjeteve fikse, ose (3) anulimi i detyrimeve nga kreditorët, pa pranimin e ndonjë vlere si kthim.

b. *Transfertat rrjedhëse* janë të nën-ndara në ato të qeverisjes qendrore dhe sektorë të tjerë;

i. Qeveria e përgjithshme përfshinë:
   (1) Grantet për Buxhetin e Kosovës;
   (2) Ndihma e donatorëve, në mallra (Programi i Investimeve Publike);
   (3) Shpenzimet e drejtpërdrejta të UNMIK-ut/EULEX-it;

ii. Sektorët tjerë - transfertat rrjedhëse të të cilave ndahen më tej në:
   (1) Remitancat/dërgesat e punëtorëve (kryesisht transfertat e emigrantëve);
   (2) Transfertat tjera - përfshijnë premiumet e sigurimit dhe kërkesave, pensioneve, disa ndihmesa financiare për institucione të ndryshme.

Burimet kryesore të të dhënave për vlerësimin e transfertave rrjedhëse janë UNMIK-u, MEF-i (Njësia e Koordinimit me Donatorë), SRTN-ja dhe Anketa mbi Buxhetin Familjar (e zbatuar nga ESK-ja).

*Remitancat e punëtorëve*. Mbulojnë transfertat rrjedhëse nga emigrantët të cilët janë të punësuar në ekonomitë e tjera dhe konsiderohen rezident atje. Emigranti është personi i cili vjen në një ekonomi dhe qëndron për një vit apo më tepër. Personat të cilët qëndrojnë në ekonomi të reja për më pak se një vit, konsiderohen jorezident; transaksionet e tyre janë të përshtatshme kryesisht për komponentin e kompensimit të punonjësve (BPM5, paragrafi 269 përmes 272).

*Vlerësimi i fluksit të remitancave nga emigrantët kosovar që jetojnë jashtë*. Vlerësimi i të hyrave nga remitancat është bërë duke u bazuar në kanalet kyçe të rrjedhjes së tyre. Një varietet i burimeve të të dhënave është përdorur për matjen e fluksit hyrës të remitancave. Kryesisht jemi fokusuar për identifikimin e fluksit të regjistruar që vjen nga kanalet zyrtare (bankat, ATM-të dhe parat e deklaruara tek Autoritetet Doganore) dhe remitancat që vijnë përmes kanaleve joformale (të pa deklaruara, siç është keshi që kalon nëpërmjet të doganave, transaksionet jo në kesh si transferi i mallrave nga emigrantët që jetojnë jashtë (shiqoni skemën e mëposhtme).




*Vlerësimi i fluksit të jashtëm të të huajve të cilët konsiderohen rezident të Kosovës*. Në anën e debitit të remitancave përfshihen remitancat përkitazi me (1) stafin ndërkombëtar - me punë afatgjate në UNMIK/EULEX dhe (2) stafin tjetër ndërkombëtar të përfshirë në projekte të tjera (p.sh. PiP). Vlerësohet se të ardhurat e stafit ndërkombëtar dedikuar të afërmve të tyre janë 76%. Burimet e të dhënave në anën e debitit janë buxheti i UNMIK-ut/EULEX-it, Ministria e Ekonomisë dhe Financave për Ndihmën Zyrtare për Zhvillim në Kosovë.

*Asistenca tjetër e donatorëve (ATD) për qeverinë*. Asistenca teknike është përkrahje e vazhdueshme e komunitetit ndërkombëtar për fuqizimin e aspektit institucional të Institucioneve të Kosovës, e cila kryesisht është zotuar dhe lëvruar përmes: investimeve kapitale, asistencës teknike, furnizimit të pajisjeve, kreditimit (investimit në infrastrukturë), trajnimit dhe të tjera. Të dhënat në BP janë krijuar duke u bazuar në raportin e hartuar nga Qendra Koordinuese e Donatorëve. Supozimet dhe vlerësimet përkitazi me transaksionet e ATD-së dhe stafit janë të ngjashme si në rastin e UNMIK-ut.

**LLOGARIA KAPITALE.** Në kuadër të *llogarisë kapitale* janë të përfshira investimet në ndërtim të bëra nga KFOR-i dhe transfertat e emigrantëve. Burimet kyçe të informacionit për transfertat e emigrantëve janë të dhënat nga KFOR-i dhe SRTN-ja.

**LLOGARIA FINANCIARE.** Përfshinë transaksionet në mjetet e huaja financiare (kërkesat ndaj jorezidentëve) dhe detyrimet e huaja financiare (detyrimet ndaj jorezidentëve). Të katër kategoritë (investimi direkt, investimi portofolio, investimet tjera dhe mjetet rezerve), bazohen kryesisht në marrëdhënien në mes të palëve, dhe së dyti mbi natyrën e instrumentit të përfshirë.

1. **Investimet Direkte** janë kategori e investimeve ndërkombëtare që, bazuar në pronësinë e të paktën 10% të ekuitetit, reflekton interesin e përhershëm nga rezidenti në një ekonomi (investuesi direkt) në ndërmarrjen rezidente në një ekonomi tjetër (ndërmarrja investuese direkte). Duke përdorur këtë kriter, marrëdhënia direkte e investimit mund të ekzistojë në mesin e një numri të ndërmarrjeve të bashkuara, pavarësisht nëse lidhja përfshin një varg zingjiror të vetëm apo një numër të vargjeve zingjirore. Komponentët e transaksioneve të investimit direkt janë:

   a. Kapitali aksionar - përfshinë investimet në filjala, aksionet në nëndegë dhe ortakët (përveç aksioneve të preferuara jo participuese që trajtohen si letra me vlerë të borxhit), dhe kontributet e tjera të kapitalit;
   b. Fitimet e ri-investuara - përbëhen nga të hyrat e kompensuara për llogarinë rrjedhëse korresponduese të mjetit të hyrave: është pjesa e investitorit direkt e fitimit të pa-shpërndar të degëve të tyre, nëndegëve dhe ortakëve;

c. Kapitali tjetër - mbulon të gjitha transaksionet financiare ndërmjet degëve (huamarrjen dhe huadhënien e fondeve), përfshirë letrat me vlerë të borxhit dhe kreditë tregtare.

Sipas standardeve ndërkombëtare (FMN-ja, BQE-ja, Eurostat-i dhe OECD-ja) fluksi i investimeve direkte regjistrohet në baza të drejtimit (më saktë se në bazë të pasurive/detyrimeve): investimi direkt jashtë vendit - si mjet, dhe investimi direkt në vendin raportues - si detyrim. Investimi direkt jashtë vendit mbulon investimet neto nga ndërmarrjet amë rezidente të Kosovës, në filjalat e huaja, nëndegët dhe kompanitë e lidhura. Investimi direkt në Kosovë përfshinë investimet neto nga kompanitë e huaja në filialat e tyre të vendosura në Kosovë. BQK-ja përdor burime të ndryshme të informatave për kalkulimin e IHD-ve. Burimi kyç i informacionit për vlerësimin e IHD-ve në Kosovë është Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP), raportet e bankave komerciale për BQK-në (SRTN), Anketat e ndërmarrjeve.

2. ***Investimet në letra me vlerë (Portofolio)*** mbulon përvetësimin dhe dispozicionin e ekuitetit dhe letrave me vlerë të borxhit, të cilat nuk mund të klasifikohen në kuadër të transaksioneve të investimeve direkte apo të mjeteve rezerve. Letrat me vlerë të përfshira janë të tregtuara (apo të tregtueshme) në tregjet e organizuara dhe tregjet e tjera financiare. Letrat me vlerë të borxhit përfshijnë bonat dhe dëftesat, që përmbajnë afat të kohëzgjatjes më shumë se një vit dhe instrumentet e tregut të parasë me kohëzgjatje prej një viti apo me pak. Të dhënat mbi letrat me vlerë të borxhit, në rastin e Kosovës, përfshijnë investimet në letrat me vlerë jashtë nga BQK-ja dhe bankat komerciale. Burimi kryesor i informatave mbi portofolin e investimeve janë të dhëna të siguruara nga BQK-ja dhe bankat komerciale që operojnë në Kosovë.

3. **Investimet tjera** mbulojnë mjetet dhe detyrimet tjera nga ato të klasifikuara për investimet direkte, investimet portofolio apo mjetet rezervë. Investimet tjera pra përfshijnë huadhëniet afatshkurta dhe afatgjata, valutën dhe depozitat, kreditë tregtare dhe mjetet dhe detyrimet tjera. Kreditë tregtare afatshkurta përfshijnë parapagesat nga jorezidentët për eksportet e ardhshme (në anën e detyrimeve) dhe pagesat e pritura të vonuara për eksport nga ana e jorezidentëve (në anën e pasurive). Vlerësimi i kredive tregtare është bërë duke përdorur proporcionin e këtyre dy kategorive tek gjithsej importet dhe eksportet raportuara në SRTN. Informata lidhur me valutën dhe depozitat, huadhëniet dhe mjetet e tjera janë siguruar nga bilanci i gjendjes i bankave komerciale, bilanci i gjendjes i BQK-së, MEF-it (depozitat qeveritare jashtë), bilanci i gjendjes i institucioneve tjera financiare, SRTN-ja (depozitat dhe huadhëniet e entiteteve jo-financiare me jashtë) dhe anaketat e ndërmarrjeve (llogari tjera të pagueshme/arkëtueshme).

**4. Mjetet rezervë**. Bazuar në BPM5 (paragrafi 424), mjetet rezerve përbëhen nga ato mjete të jashtme të cilat janë të gatshme dhe të kontrolluara nga autoritetet monetare për financim direkt të mos balancimit të pagesave, për rregullimin indirekt të madhësisë së mos balancimit të tillë përmes intervenimit në tregjet e këmbimit valutor për të influencuar normën e këmbimit valutor dhe/ose për qëllime të tjera. Mjetet rezerve përbëhen nga:
   - Ari monetar,
   - Të drejtat Speciale të Tirazhit (SDR),
   - Pozicioni i rezervave në Fond,
   - Valuta e jashtme,
   - Kërkesat tjera.

   Në rastin e Kosovës, mjetet rezervë janë vetëm në formë të monedhës së huaj. Prandaj, mjetet rezervë janë të përbëra nga po thuaj të gjitha kërkesat e BQK-së ndaj jorezidentëve (Valuta, Depozitat dhe Letrat me Vlerë tjera nga aksionet), duke zbritur ngarkesat e depoziatve në BQK (Agjencioni Kosovar i Privatizimit dhe Fondet Pensionale).

**GABIMET DHE LËSHIMET NETO.** Shuma e të hyrave në anën e kredisë, në parim, duhet të barazojë shumën e të hyrave në anën e debisë përgjat periudhës. Në praktikë, meqë disa transaksione mund të mos

përfshihen apo për shkak të diferencës në mbulueshmëri, vlerësimi dhe koha e transaksioneve, nuk paraqet simetri ekzakte dhe zëri balancues i gabimeve dhe harresave neto shfaqet për të balancuar llogarinë e përgjithëshme. Teorikisht, madhësia e këtij zëri duhet të jetë relativisht e vogël në raport me vlerën e kombinuar të të gjitha transaksioneve në kredi dhe debi të shprehura në terma absolut.

**TABELAT 35-38: EXPORTET DHE IMPORTET**

Sistemi i harmonizuar i kodeve i përdorur në prezantimin e statistikave të tregtisë së jashtme është me sa vijon:

I. Kafshët e gjalla; produkte të kafshëve;
II. Produkte të perimeve;
III. Yndyrat dhe vajrat shtazore dhe bimore dhe produktet e tyre të ndara; përgatitja e yndyrave të përshtatshme për ngrënie; dylli shtazor dhe bimor;
IV. artikujve ushqimor të pregaditur; pijet alkoholike dhe uthulla; duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit;
V. Produktet minerale;
VI. Produktet e kemikaleve apo industritë e ngjajshme;
VII. Plastikat dhe artikujt nga kjo; goma dhe artikujt nga kjo;
VIII. Lëkurat e papërpunuara dhe të përpunuara; takëme kuajsh dhe pajime të tyre; gjësende të udhëtimit, çanta dore dhe mbajtëset e ngjajshme;
IX. Druri dhe artikuj nga druri; qymyr druri; dru tape dhe artikuj të tjerë nga to; produkte të kashtës, xunkthtari dhe thurjet;
X. Pulpa e drurit apo materiale tjera fibrozë celuloze; mbeturina dhe plehëra të kartonave; letër e kartonave dhe artikuj të tyre;
XI. Tekstili dhe artikuj tekstili;
XII. Mbathje, kapela, ombrella, ombrella dielli, shkop për ecje, shufra; pupla dhe artikuj tjerë të punuara nga to; lule artificiale; artikuj të flokëve të njeriut;
XIII. Lëkurat e papërpunuara dhe të përpunuara; takëme kuajsh dhe pajime të tyre; gjësende të udhëtimit, çanta dore dhe mbajtëset e ngjajshme;
XIV. Perla natyrale ose të përpunuara, gurë të çmuar dhe gjysmë të çmuar, metale të çmuara, metale të mveshura me metale të çmuara dhe të tjera të tilla; imitime të xhevahirëve; monedha të metalta;
XV. Metalet bazë dhe artikuj të metaleve bazë;
XVI. Makineria dhe aplikimet mekanike; pajisjet elektrike; pjesët e tyre; regjistruesit dhe ri-prodhuesit e zërit, dhe pjesë plotësuese të këtyre artikujve;
XVII. Mjetet e transportit;
XVIII. Instrumentet optike, mjekësore dhe muzikore;
XIX. Armët dhe municionet;
XX. Artikujt të ndryshëm të prodhuar;
XXI. Të tjera.

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës